



KUVENDI I SHQIPËRISË

DISKURSI POLITIK & PUBLIK

MBI

DEKRIMINALIZIMIN

Raport monitorimi
Prill - Qershor 2026



Instituti i Studimeve Politike (ISP) është duke realizuar projektin “Promovimi i llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur” mbështetur nga NED (National Endowment for Democracy). Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë përgjegjësi e ISP-së.

**Ekspert
Ardi Stefa**

@Instituti i Studimeve Politike

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

Web: www.isp.com.al

E-mail: contactaips@isp.com.al

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

HYRJE: KONTEKSTI DHE METODOLOGJIA	4
1. GJETJET DHE REKOMANDIMET KRYESORE	5
i. Gjetjet kryesore	6
ii. Rekomandimet kryesore	10
2. DISKURSI POLITIK PËR DREJTËSINË DHE SPAK.....	13
i. Qëndrimet e qeverisë	13
ii. Qëndrimet e opozitës	13
iii. Retorika për “ndarjen e pushteteve”	14
3. ROLI I FAKTORËVE NDËRKOMBËTARË	15
i. BE, SHBA, ambasadat.....	15
ii. Qëndrimet ndaj SPAK dhe korrupsionit	16
iii. Ndikimi në integrim.....	16
4. KLIMA POLITIKE DHE DISKURSI PUBLIK	17
i. Polarizimi politik	17
5. DOMINIMI MEDIATIK I PS/PD.....	19
i. Indeksi për dominim mediatik	19
ii. Dominimi sipas platformave	22
6. PROTESTAT E QERSHORIT DHE NDRYSHIMI I DISKURSIT POLITIK.....	23
i. Protestat dhe reagimet, qytetarët dhe politika	24

HYRJE: KONTEKSTI DHE METODOLOGJIA

Ky raport paraqet një analizë të diskursit publik dhe politik në Shqipëri gjatë periudhës **prill–qershor 2026**, me fokus te mënyra se si temat e **dekriminalizimit, integritetit publik, drejtësisë, korrupsionit dhe llogaridhënies institucionale** u trajtuan në hapësirën publike. Në qendër të analizës nuk qëndron vetëm evidentimi i ngjarjeve politike apo institucionale të periudhës, por sidomos mënyra se si këto ngjarje u interpretuan, u përdorën dhe u shndërruan në narrativa politike, mediatike dhe qytetare.

Raporti bazohet në premisën se dekriminalizimi nuk është vetëm një mekanizëm formal ligjor për verifikimin e figurës së zyrtarëve, kandidatëve apo funksionarëve publikë. Në një kuptim më të gjerë demokratik, ai lidhet edhe me standardet e integritetit politik, etikën e përfaqësimit, përgjegjësinë publike, raportin e partive me drejtësinë, kulturën e dorëheqjes dhe distancimin nga praktikat që cenojnë besimin qytetar. Për këtë arsye, analiza e diskursit publik merr rëndësi të veçantë: ajo ndihmon për të kuptuar nëse integriteti trajtohet si standard i qëndrueshëm institucional, apo vetëm si instrument i përplasjes politike.

Periudha prill–qershor 2026 shënon një fazë të ngjeshur të zhvillimeve politike dhe publike. Në dokumentet e monitorimit, kjo periudhë karakterizohet nga prania e disa temave të përsëritura në komunikimin publik: integrimi europian, SPAK-u, korrupsioni, funksionimi i demokracisë, protestat, zgjedhjet dhe Kuvendi. Këto tema nuk u shfaqën të izoluara nga njëra-tjetra, por u ndërthurën në një debat më të gjerë mbi cilësinë e qeverisjes, besimin ndaj institucioneve dhe përgjegjësinë e aktorëve politikë. Në këtë periudhë, debati publik u zgjerua përtej përplasjes tradicionale mazhorancë–opozitë. Krahas aktorëve kryesorë partiakë, në diskurs u shfaqën më dukshëm edhe protestuesit dhe grupimet qytetare, të cilët ndikuan në agjendën publike dhe sollën një gjuhë më të drejtpërdrejtë mbi përgjegjësinë politike, korrupsionin dhe ndryshimin e modelit të përfaqësimit. Kjo e bën periudhën prill–qershor të rëndësishme jo vetëm si zhvillim politik, por edhe si moment reflektimi mbi raportin midis qytetarëve, partive dhe institucioneve.

Në funksion të këtij raporti, diskursi publik është trajtuar si një fushë ku maten jo vetëm pozicionet politike, por edhe cilësia e komunikimit demokratik. Mënyra se si aktorët publikë flasin për drejtësinë, për SPAK-un, për korrupsionin, për protestat apo për integrimin europian ndikon drejtpërdrejt në perceptimin qytetar për institucionet. Kur drejtësia paraqitet vetëm si armë politike, kur korrupsioni përdoret vetëm si etiketim ndaj kundërshtarit, apo kur integriteti relativizohet sipas interesit të momentit, rreziku është që debati publik të humbasë funksionin e tij kontrollues dhe të shndërrohet në mjet polarizimi. Objekti i raportit nuk është të përcaktojë përgjegjësi penale, as të vlerësojë fajësinë apo pafajësinë e individëve të përmendur në debatin publik. Kjo mbetet kompetencë e institucioneve të drejtësisë. Qëllimi i analizës është të vlerësojë mënyrën se si aktorët politikë, mediat dhe grupimet qytetare i përdorin këto zhvillime në komunikimin publik, si ndërtohen narrativat mbi integritetin dhe cilat janë prirjet kryesore që ndikojnë në besimin ndaj institucioneve.

Raporti është hartuar mbi bazën e monitorimit të mediave televizive, portaleve informative, shtypit të shkruar, deklaratave publike të aktorëve politikë, komunikimeve në rrjete

sociale, seancave parlamentare dhe raportimeve mbi zhvillimet institucionale. Njësitë e analizës janë ngjarjet dhe deklaratimet që lidhen me drejtësinë, korrupsionin, integritetin publik, dekriminalizimin, funksionimin e Kuvendit, protestat dhe procesin e integritetit evropian. Për secilën prej këtyre fushave është vlerësuar jo vetëm përmbajtja faktike, por edhe tonaliteti, gjuha e përdorur, referencat institucionale, niveli i konfliktualitetit dhe pozicionimi i aktorëve.

Të dhënat e detajuara të monitorimit, përfshirë kronologjitë, citimet e plota, tabelat e kodimit dhe klasifikimet sipas aktorëve apo burimeve mediatike, nuk janë objekt i publikimit të plotë. Ato shërbejnë si bazë e brendshme analitike për hartimin e këtij raporti. Versioni publik synon të ofrojë një lexim të përmbledhur dhe të kuptueshëm të prirjeve kryesore, duke shmangur mbingarkimin me të dhëna teknike dhe duke ruajtur fokusin te interpretimi institucional i zhvillimeve.

Një rëndësi të veçantë në analizë ka marrë raporti midis drejtësisë dhe politikës. SPAK-u dhe institucionet e drejtësisë u referuan shpesh në komunikimin publik, jo vetëm si institucione procedurale, por edhe si simbole të luftës kundër korrupsionit, të ndëshkimit të pandëshkueshmërisë, ose, në varësi të aktorit politik, si objekt kritikash për selektivitet, vonesa apo ndikime të supozuara. Kjo tregon se drejtësia është kthyer në një nga fushat kryesore ku ndërtohet ose kontestohet legjitimiteti politik. Po aq i rëndësishëm është edhe raporti midis integritetit evropian dhe integritetit publik. Gjatë periudhës së monitorimit, integrimi evropian u përdor si referencë e rëndësishme në komunikimin politik. Për disa aktorë, ai shërbeu si dëshmi e progresit institucional dhe e funksionimit të reformave; për të tjerë, si tregues i pengesave që burojnë nga korrupsioni, mungesa e konkurrencës, problemet me shtetin e së drejtës apo dobësitë e përfaqësimit politik. Në këtë mënyrë, procesi evropian u shndërrua në një pasqyrë për debatin e brendshëm mbi standardet e qeverisjes dhe integritetit.

Raporti merr në konsideratë edhe ndryshimin e peshës së aktorëve në diskursin publik. Materialet e monitorimit evidentojnë se, përveç mazhorancës dhe opozitës, protestuesit u shfaqën si aktor me rol të dukshëm në periudhën prill–qershor, duke e orientuar një pjesë të debatit drejt kërkesave për llogaridhënie, ndryshim politik dhe reformim të sistemit përfaqësues. Ky element e zgjeron analizën përtej komunikimit partiak dhe e vendos çështjen e integritetit në një kuadër më të gjerë qytetar. Në këtë kontekst, raporti synon të ofrojë një vlerësim të balancuar të diskursit publik.

Raporti në vijim paraqet gjetjet kryesore, rekomandimet dhe interpretimin e të dhënave grafike, me qëllim identifikimin e prirjeve që ndikuan në diskursin publik gjatë periudhës prill–qershor 2026. Në qendër të analizës qëndron pyetja nëse dekriminalizimi dhe integriteti po konsolidohen si standarde të jetës publike, apo nëse vijojnë të përdoren kryesisht si instrumente të komunikimit dhe konfliktit politik.

1. GJETJET DHE REKOMANDIMET KRYESORE

Bazuar në të dhënat e monitorimit dhe përpunimin statistikor të tyre, stafi i ISP ka evidentuar në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet kryesore.

i. Gjetjet kryesore

Analiza e diskursit publik dhe politik për periudhën prill–qershor 2026 tregon se temat e dekriminalizimit, integritetit, drejtësisë dhe korrupsionit nuk u trajtuan si çështje të ndara, por si pjesë e një përplasjeje më të gjerë mbi legjitimitetin moral të pushtetit, funksionimin e institucioneve dhe besueshmërinë e sistemit politik. Në këtë periudhë, diskursi publik u zhvillua rreth disa boshteve kryesore: integrimi europian, SPAK-u, korrupsioni, protestat, funksionimi i Kuvendit, demokracia e brendshme partiake dhe kërkesa qytetare për llogaridhënie.

Një tipar i përgjithshëm i periudhës është se debati publik nuk mbeti më vetëm në formatin klasik mazhorancë–opozitë. Dokumentet e monitorimit evidentojnë shfaqjen e një konfigurimi tripolar, ku krahas mazhorancës dhe opozitës, protestuesit u shfaqën si aktor i tretë i rëndësishëm në diskursin publik. Mazhoranca e ndërtoi komunikimin mbi integrimin europian, stabilitetin institucional dhe mbështetjen për reformën në drejtësi; opozita e përqendroi komunikimin te korrupsioni, kriza e demokracisë dhe kontestimi i funksionimit të drejtësisë; ndërsa protestuesit artikuluan një refuzim më të përgjithshëm të elitës politike dhe një kërkesë më të drejtpërdrejtë për ndëshkim, dorëheqje dhe reformim të sistemit.

1) Diskursi mbi dekriminalizimin dhe integritetin u zhvendos nga rrafshi ligjor në rrafshin politik dhe moral.

Gjatë periudhës së monitoruar, dekriminalizimi nuk u artikulua vetëm si proces verifikimi formal i figurës së zyrtarëve apo kandidatëve, por si kategori më e gjerë politike. Në diskursin publik, integriteti u lidh me korrupsionin, lidhjet e dyshuara me krimin, abuzimin me pushtetin, klientelizmin, ndikimin mbi drejtësinë, kontrollin e institucioneve dhe mungesën e përgjegjësisë politike. Kjo e zgjeroi kuptimin publik të dekriminalizimit, por njëkohësisht krijoi edhe rrezikun e përdorimit të tij si instrument delegjitimimi. Aktorët politikë shpesh nuk e trajtuan integritetin si standard të përbashkët që duhet të vlejë për të gjitha palët, por si armë retorike për të dëmtuar kundërshtarin. Në vend që debati të fokusohet te mekanizmat institucionalë për parandalimin e kriminalizimit të politikës, ai u përqendrua shpesh te akuza të ndërsjella, etiketime politike dhe interpretime selektive të hetimeve apo zhvillimeve gjyqësore.

2) Diskursi politik u dominua nga delegjitimimi i kundërshtarit.

Një nga gjetjet kryesore të monitorimit është se diskursi politik dominohet më shumë nga përpykja për të delegjitimuar kundërshtarin, sesa nga debati mbi politika publike konkrete. Kjo del qartë edhe në materialet përmbledhëse të monitorimit, ku theksohet se debati publik gjatë periudhës prill–qershor u karakterizua nga delegjitimimi, sulmet personale, akuzat për korrupsion dhe përdorimi i drejtësisë si fushëbetëjë politike. Mazhoranca e paraqiti veten si garantuese të integritetit europian, stabilitetit dhe reformës në drejtësi, ndërsa opozitën si pengesë, bllokuese ose aktor që dëmton interesin kombëtar në raport me procesin europian.

Opozita, nga ana tjetër, e paraqiti mazhorancën si burim të korrupsionit të vazhdueshëm, pengesë për integrimin dhe faktor të kapjes së institucioneve. Kjo krijoi një diskurs ku secila palë e trajtonte veten si bartëse të legjitimitetit publik dhe kundërshtarin si kërcënim ndaj shtetit, drejtësisë ose demokracisë. Në këtë klimë, integriteti publik nuk u trajtua si standard institucional, por si pjesë e betejës për besueshmëri morale, gjë e cila dobëson cilësinë e debatit publik, sepse zhvendos vëmendjen nga zgjidhjet të akuzat, nga reformat të etiketimet dhe nga përgjegjësia institucionale të përplasja personale.

3) SPAK-u mbeti institucioni më i referuar dhe simboli kryesor i përplasjes politike.

SPAK-u u shndërrua në boshtin kryesor të debatit publik mbi drejtësinë, korrupsionin dhe integritetin. Në dokumentet e monitorimit, SPAK identifikohet si institucioni më i referuar në diskursin publik dhe si fusha kryesore e përplasjes politike. Në diskursin e mazhorancës, SPAK-u dhe reforma në drejtësi u përdorën si prova se sistemi po funksionon, se pandëshkueshmëria po cenohet dhe se Shqipëria po përmbush standardet e kërkuara nga procesi i integritetit evropian. Në diskursin e opozitës, SPAK-u u përdor në mënyrë të dyfishtë: si instrument legjitim kur godet figura të mazhorancës dhe si objekt kritike kur perceptohet si selektiv, i ngadalshëm ose i ndikuar politikisht. Kjo qasje e dyzuar tregon se institucionet e drejtësisë janë ende të ekspozuara ndaj presionit të lartë politik dhe interpretimit të njëanshëm. Mbështetja për drejtësinë mbetet shpesh e kushtëzuar nga objekti i hetimit: aktorët politikë e mbështesin SPAK-un kur veprimet e tij godasin kundërshtarin, por e vënë në diskutim ose e sulmojnë kur ato prekin kampin e tyre politik.

4) Integrimi evropian u përdor si instrument legjitimiteti politik.

Integrimi evropian ishte një nga temat më të pranishme në diskursin publik të periudhës. Në prill 2026, monitorimi evidenton dy narrativa diametralisht të kundërta: mazhoranca argumentonte se Shqipëria po ecën drejt BE-së, korrupsioni po luftohet dhe reforma në drejtësi po funksionon; opozita pretendonte se Shqipëria po largohet nga BE-ja, korrupsioni po bllokoi integrimin dhe drejtësia është e kapur. Kjo tregon se integrimi evropian nuk u trajtua vetëm si proces institucional ose teknik, por si instrument për të fituar betejën e legjitimitetit publik. Për mazhorancën, integrimi u përdor si dëshmi e suksesit të qeverisjes dhe reformave. Për opozitën, ai u përdor si provë e dështimit të qeverisë për shkak të korrupsionit dhe mungesës së standardeve demokratike. Në këtë kuptim, integrimi evropian dhe integriteti publik u ndërthurën ngushtë. Debatit mbi BE-në u kthye në debat mbi korrupsionin, drejtësinë, cilësinë e qeverisjes dhe besueshmërinë e aktorëve politikë.

5) Korrupsioni u bë narrativa kryesore e opozitës dhe pika më e fortë e kontestimit politik.

Korrupsioni ishte një nga temat më të përdorura për të interpretuar zhvillimet politike, ekonomike dhe institucionale. Në diskursin opozitar, ai u paraqit si problem i vazhdueshëm, si

pengesë për integrimin europian dhe si shenjë e kapjes së shtetit. Temat më të përsëritura përfshinin projektet strategjike, koncesionet, portet turistike, fondet IPARD, prokurimet publike dhe hetimet ndaj zyrtarëve të lartë. Mazhoranca, nga ana tjetër, e pranoi korrupsionin si problem, por e paraqiti atë si fenomen që po luftohet përmes reformës në drejtësi, SPAK-ut dhe përmirësimit të standardeve administrative. Ky dallim krijoi dy realitete politike paralele: një narrativë qeveritare të progresit institucional dhe një narrativë opozitare të krizës së qeverisjes. Gjetja kryesore këtu është se korrupsioni nuk u trajtua vetëm si çështje penale ose administrative, por si kategori politike që përcaktonte besueshmërinë e aktorëve.

6) Protestat qytetare ndryshuan balancën e diskursit publik.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme të periudhës ishte rritja e rolit të protestave qytetare. Në materialet e monitorimit theksohet se protestuesit u shfaqën si aktor me retorikë më radikale, duke artikuluar refuzim të elitës politike, kërkesë për ndëshkim të politikanëve, mobilizim qytetar dhe ndryshim sistemi. Protestat nuk u përfshinë plotësisht në narrativën e opozitës tradicionale, edhe pse opozita u përpoq t'i përdorte si provë të krizës së qeverisjes. Karakteri qytetar i protestave kufizoi aftësinë e partive për t'i monopolizuar ato. *Kjo tregon se një pjesë e shoqërisë nuk e sheh më integritetin vetëm si çështje të alternimit partiak, por si problem më të gjerë të modelit politik.* Diskursi qytetar u dallua nga ai partiak sepse u fokusua te reforma institucionale, kufizimi i mandateve, kontrata e re sociale dhe refuzimi i elitave tradicionale. Kjo e zgjeron kuptimin e integritetit publik përtej ligjit të dekriminalizimit dhe e lidh atë me cilësinë e përfaqësimit, përgjegjësinë politike dhe modelin e qeverisjes.

7) Gjuha politike u bë më konfliktuale dhe më pak konstruktive.

Monitorimi evidenton rritje graduale të gjuhës konfliktuale, veçanërisht në kampin opozitar, por edhe në komunikimin e përgjithshëm politik. Tabelat përmbledhëse tregojnë se opozita përdori një retorikë më konfliktuale dhe mobilizuese, ndërsa mazhoranca u mbështet më shumë te argumenti institucional dhe procesi i integritetit europian. Megjithatë, të dy kampet karakterizohen nga nivel i lartë polarizimi dhe mungesë e gjuhës së kompromisit gjë e cila sjell pasoja për klimën demokratike. Kur gjuha politike dominohet nga etiketime, akuza, personalizim dhe delegjitimim, hapësira për dialog institucional zvogëlohet. Debati mbi integritetin kthehet në përplasje morale, ku secila palë e sheh veten si të pastër dhe kundërshtarin si të inkriminuar ose të korruptuar. Kjo mënyrë komunikimi e dobëson mundësinë për reforma konsensuale në fushën e dekriminalizimit, financimit të partive, kontrollit të pasurisë, integritetit të kandidatëve dhe forcimit të institucioneve të pavarura.

8) Kuvendi u shfaq më shumë si arenë konflikti, sesa si hapësirë kontrolli dhe llogaridhënieje.

Funksionimi i Kuvendit ishte një tjetër bosht i rëndësishëm i diskursit publik. Në muajin prill, nga monitorimi evidentohet konflikti mazhorancë–opozitë, debate të ashpra, bllokim i foltores,

masa disiplinore, ankesa për kufizim të të drejtave të opozitës dhe përplasje lidhur me interpelancat, komisionet hetimore dhe procesin e integritetit europian. Kjo tregon se Kuvendi nuk u perceptua si hapësirë efektive e kontrollit parlamentar dhe debatit institucional, por si arenë e përplasjes politike. Për çështjet që lidhen me integritetin, kjo është problematike, sepse Kuvendi duhet të jetë një nga institucionet kryesore për kontrollin e qeverisë, transparencës, hetimin parlamentar dhe ndërtimin e standardeve të përgjegjësisë publike. Dobësimi i debatit parlamentar dhe zëvendësimi i tij me konflikt verbal e zvogëlon besimin publik te institucionet përfaqësuese dhe e shtyn diskursin publik drejt rrugës, rrjeteve sociale dhe polarizimit mediatic.

9) Demokracia e brendshme partiake u shfaq si pjesë e debatit mbi integritetin.

Zhvillimet brenda partive politike, sidomos tensionet dhe përplasjet në Partinë Demokratike, ngritën pyetje mbi standardet e demokracisë së brendshme, konkurrencës reale dhe respektimit të mendimit ndryshe. Raporti evidenton se përplasjet brenda PD-së u shfaqën në dy plane: lufta për kontrollin e strukturave dhe përjashtimet politike që ushqyen narrativën e “*spastrimit*” të zërave kritikë. Ky element është i rëndësishëm për temën e integritetit, pasi partitë politike nuk mund të kërkojnë standarde të larta publike pa zbatuar standarde të brendshme demokratike. Dekriminalizimi dhe integriteti nuk lidhen vetëm me të kaluarën penale të individëve, por edhe me mënyrën se si partitë përzgjedhin kandidatët, menaxhojnë konkurrencën e brendshme, trajtojnë kritikën dhe vendosin standarde etike për përfaqësimin publik.

10) Faktori ndërkombëtar u përdor si burim legjitimiteti nga të gjitha palët.

Gjatë periudhës së monitoruar, aktorët politikë iu referuan shpesh Bashkimit Europian, raporteve ndërkombëtare, partnerëve strategjikë dhe institucioneve ndërkombëtare për të mbështetur qëndrimet e tyre. Mazhoranca përdori referencat ndërkombëtare për të argumentuar progresin dhe legjitimitetin institucional; opozita i përdori për të denoncuar shkelje, korrupsion ose devijime nga standardet europiane. Kjo tregon se faktori ndërkombëtar vijon të ketë rol të rëndësishëm në diskursin shqiptar mbi integritetin. Megjithatë, përdorimi selektiv i tij mund ta zbehë funksionin real të standardeve ndërkombëtare. Raportet dhe qëndrimet ndërkombëtare duhet të shërbejnë si bazë për reforma të brendshme, jo vetëm si argumente të ditës në përplasjen politike.

11) Media dhe rrjetet sociale amplifikuan polarizimin.

Media dhe rrjetet sociale luajtën rol të rëndësishëm në përhapjen e narrativave politike. Në shumë raste, debati publik u formësua nga deklaratat e shkurtra, tituj konfliktualë, reagime të menjëhershme dhe interpretime të forta politike. Kjo e rriti shpejtësinë e qarkullimit të informacionit, por njëkohësisht e bëri më të vështirë ndarjen midis faktit, komentit, akuzës dhe propagandës. Në çështjet që lidhen me drejtësinë; hetimet, masat e sigurisë, procedimet

penale dhe deklaratat e institucioneve shpesh u përkthyen menjëherë në fitore ose humbje politike. Kjo rrit rrezikun e gjykimit publik paraprak dhe mund të ndikojë negativisht në besimin te procesi i rregullt ligjor.

12) Dekriminalizimi rrezikon të reduktohet në retorikë, nëse nuk shoqërohet me standarde të matshme.

Gjetja përmbyllëse është se dekriminalizimi dhe integriteti kanë prani të lartë në diskurs, por jo gjithmonë shoqërohen me propozime konkrete institucionale. Aktorët politikë flasin shpesh për korrupsion, krim, kapje të shtetit, drejtësi selektive dhe përgjegjësi publike, por më rrallë paraqesin mekanizma të qartë për parandalimin e kriminalizimit të politikës, kontrollin e pasurisë, verifikimin e kandidatëve, forcimin e etikës partiake ose rritjen e transparencës së financimit politik. Kjo krijon hendek midis gjuhës dhe praktikës së integritetit. Për të qenë efektiv, dekriminalizimi duhet të kalojë nga retorika politike te standardet e matshme, procedurat e qarta dhe përgjegjësia institucionale.

ii. REKOMANDIMET KRYESORE

Bazuar në gjetjet e mësipërme, raporti rekomandon një qasje më të strukturuar ndaj dekriminalizimit dhe integritetit publik. Qëllimi nuk duhet të jetë vetëm reagimi ndaj rasteve individuale, por ndërtimi i një kulture të qëndrueshme institucionale, ku partitë, Kuvendi, institucionet e drejtësisë, media dhe shoqëria civile të kontribuojnë në forcimin e standardeve të përgjegjësisë publike.

1) Partitë politike duhet ta trajtojnë integritetin si standard të brendshëm, jo vetëm si akuzë ndaj kundërshtarit.

Partitë politike duhet të miratojnë dhe zbatojnë mekanizma të qartë të vetëkontrollit për kandidatët, zyrtarët e zgjedhur dhe funksionarët politikë. Këta mekanizma duhet të përfshijnë verifikimin e figurës, transparencën e burimeve financiare, konfliktet e interesit, lidhjet klienteliste dhe reagimin institucional ndaj rasteve kur përfaqësuesit publikë përfshihen në hetime serioze. Standardi i integritetit nuk mund të përdoret vetëm kundër kundërshtarit politik. Çdo parti duhet të ketë rregulla të brendshme që përcaktojnë se si veprohet kur një përfaqësues i saj akuzohet, hetohet, dënohet ose përfshihet në afera që cenojnë besimin publik. Mungesa e

reagimit të brendshëm dëmton besueshmërinë e gjithë sistemit politik.

2) Të forcohen standardet e përzgjedhjes së kandidatëve dhe zyrtarëve politikë.

Përzgjedhja e kandidatëve për funksione publike duhet të kalojë përtej kriterëve minimale ligjore. Përveç respektimit të ligjit të dekriminalizimit, partitë duhet të aplikojnë standarde shtesë të integritetit, si transparenca e pasurisë, historiku i ushtrimit të funksioneve publike, mungesa e lidhjeve të dyshimta, etika personale dhe aftësia për të përfaqësuar qytetarët pa konflikt interesi. Në këtë drejtim, rekomandohet që partitë të publikojnë kriteret e qarta për kandidaturat, të krijojnë komisione të brendshme integriteti dhe të bëjnë publike arsyetimin për përzgjedhjen e kandidatëve në pozicione të rëndësishme.

3) Kuvendi duhet të forcojë rolin e tij kontrollues dhe të shmangë kthimin në arenë të konfliktit verbal.

Kuvendi duhet të rikthehet në funksionin e tij themelor si hapësirë kontrolli, llogaridhënieje dhe debati institucional. Për këtë qëllim, rekomandohet respektimi i të drejtave të opozitës për interpelanca, komisione hetimore, mocione me debat dhe akses në informacion, por njëkohësisht edhe respektimi i rregullave të etikës parlamentare nga të gjitha palët. Masat disiplinore nuk duhet të përdoren si instrument politik dhe as sjellja bllokuese nuk duhet të zëvendësojë debatin parlamentar. Për çështjet e integritetit, Kuvendi duhet të krijojë më shumë hapësirë për diskutim të bazuar në dokumente, raporte, të dhëna dhe analiza institucionale.

4) Kod etik për gjuhën publike të zyrtarëve politikë.

Gjuha e përdorur nga zyrtarët politikë ka ndikim të drejtpërdrejtë në besimin publik te institucionet. Për këtë arsye, rekomandohet miratimi ose forcimi i kodeve të sjelljes për deputetët, ministrat, drejtuesit e partive dhe zyrtarët e zgjedhur, me fokus të veçantë të shmangia e gjuhës denigruese, kërcënuese apo akuzuese pa bazë faktike. Kritika politike është pjesë e demokracisë, por ajo duhet të ndahet nga gjuha që minon institucionet, nxit urrejtje ose e shndërron kundërshtarin politik në armik. Një standard më i lartë komunikimi duhet të jetë pjesë e integritetit publik.

5) Institucionet e drejtësisë duhet të forcojnë komunikimin publik pa cenuar sekretin hetimor.

SPAK-u dhe institucionet e tjera të drejtësisë duhet të vijojnë punën e tyre në mënyrë të pavarur, por njëkohësisht të përmirësojnë komunikimin institucional me publikun. Kjo nuk nënkupton komentimin e hetimeve apo shkeljen e sekretit hetimor, por publikimin e informacionit të qartë, të saktë dhe të kuptueshëm mbi procedurat, fazat e proceseve dhe dallimin midis hetimit, akuzës dhe vendimit gjyqësor. Një komunikim më i mirë institucional do të ulte hapësirën për keqinterpretim politik dhe do të forconte besimin publik te drejtësia. Në kushtet kur SPAK është

kthyer në simbol të përplasjes politike, komunikimi profesional dhe i matur është thelbësor.

6) Aktorët politikë duhet të shmangin përdorimin selektiv të SPAK-ut.

Mbështetja ndaj SPAK-ut dhe reformës në drejtësi duhet të jetë parimore, jo selektive. Aktorët politikë duhet të shmangin praktikën e mbështetjes së institucioneve kur godasin kundërshtarin dhe sulmimit të tyre kur hetojnë përfaqësues të kampit të vet. Raporti rekomandon që partitë të artikulojnë një standard të përbashkët: respekt për hetimet, mosndërrhyrje politike, shmangie e presionit publik ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe pranimi i vendimeve gjyqësore si pjesë e shtetit të së drejtës.

7) Të forcohet transparenca mbi financimin politik dhe lidhjet me interesa ekonomike.

Një pjesë e madhe e diskursit mbi korrupsionin lidhet me koncesionet, prokurimet, projektet strategjike, portet, fondet publike dhe marrëdhënien midis politikës dhe biznesit. Për këtë arsye, rekomandohet forcimi i transparencës mbi financimin e partive, donacionet, interesat ekonomike të kandidatëve, lidhjet me kontraktorë publikë dhe përfitues të fondeve shtetërore. Dekriminalizimi duhet të lidhet jo vetëm me të shkuarën penale, por edhe me parandalimin e ndikimit të interesave të paligjshme ose klienteliste në politikë.

8) Media duhet të ndajë qartë raportimin faktik nga komentimi politik.

Media ka rol të rëndësishëm në informimin e publikut mbi drejtësinë, korrupsionin dhe integritetin, por duhet të shmangë amplifikimin e pakontrolluar të akuzave politike. Raportimi mbi hetimet dhe çështjet penale duhet të respektojë prezumimin e pafajësisë, të dallojë midis dyshimit, hetimit, akuzës dhe vendimit gjyqësor dhe të shmangë titujt që e paraqesin një proces ende të papërfunduar si fakt të provuar. Rekomandohet që redaksitë të zhvillojnë udhëzime të brendshme për raportimin mbi drejtësinë dhe integritetin publik, sidomos kur bëhet fjalë për hetime ndaj zyrtarëve të lartë ose akuza për lidhje me krimin.

9) Të krijohet një indeks periodik për integritetin e diskursit publik.

Duke qenë se raportet e monitorimit tregojnë rritje të polarizimit, delegjitimitit dhe përdorimit politik të drejtësisë, rekomandohet krijimi i një indeksi periodik për integritetin e diskursit publik. Ky indeks mund të masë disa tregues: nivelin e gjuhës denigruese, përdorimin e akuzave për korrupsion pa referencë faktike, sulmet ndaj institucioneve të drejtësisë, gjuhën e kompromisit, referencat institucionale, transparencën dhe thirrjet për llogaridhënie. Një instrument i tillë do të ndihmonte publikun dhe median të kuptojnë jo vetëm çfarë thuhet në politikë, por edhe cilësinë demokratike të mënyrës se si thuhet.

10) Të promovohet kultura e dorëheqjes dhe përgjegjësisë politike.

Në demokracitë funksionale, përgjegjësia politike nuk fillon vetëm pas një vendimi gjyqësor të

formës së prerë. Për raste që cenojnë rëndë besimin publik, partitë dhe institucionet duhet të kenë standarde të qarta për pezullim, tërheqje nga funksioni, dorëheqje ose distancim politik deri në sqarimin e plotë të çështjes. Kjo nuk duhet të përdoret si ndëshkim paraprak, por si mekanizëm për mbrojtjen e integritetit të institucionit. Një kulturë e tillë do të forconte besimin publik dhe do ta kthente integritetin nga retorikë në praktikë.

2. DISKURSI POLITIK PËR DREJTËSINË DHE SPAK

Në periudhën prill-qershor 2026, raporti politik me drejtësinë dhe SPAK-un mbeti një nga fushat më të rëndësishme të përplasjes publike. Monitorimi evidenton se drejtësia nuk u trajtua vetëm si proces institucional, por edhe si element qendror i legjitimitetit politik. Në këtë kuptim, SPAK-u u referua në mënyrë të vazhdueshme si tregues i funksionimit të reformës në drejtësi, si provë e luftës kundër korrupsionit, por edhe si objekt kontestimi politik për ritmin, selektivitetin dhe efektin e hetimeve në balancën e pushtetit. Për të shmangur personalizimin e rasteve individuale, analiza e mëposhtme fokusohet te qëndrimet e përgjithshme të aktorëve politikë dhe te mënyra se si diskursi mbi SPAK-un lidhet me ndarjen e pushteteve, integrimin evropian dhe përgjegjësinë publike.

i. Qëndrimet e qeverisë

PS/Qeveria e ndërtoi diskursin mbi drejtësinë në tre linja kryesore: mbështetjen formale për reformën në drejtësi, paraqitjen e SPAK-ut si dëshmi se institucionet po funksionojnë dhe lidhjen e luftës kundër korrupsionit me procesin e integritetit evropian. Në këtë linjë, hetimet dhe veprimet e institucioneve të drejtësisë u interpretuan si pjesë e konsolidimit të shtetit ligjor dhe jo si krizë e sistemit politik. Në komunikimin publik, PS/Qeveria përdori më shpesh referenca institucionale, standarde ndërkombëtare dhe argumente të lidhura me ecurinë e negociatave. Ky pozicion synon të krijojë një narrativë stabiliteti: sistemi është nën presion, por po funksionon; korrupsioni ekziston, por po luftohet; dhe drejtësia e re mbetet pjesë e domosdoshme e rrugës evropiane.

ii. Qëndrimet e opozitës

PD/Opozita e përdori SPAK-un dhe drejtësinë si një nga fushat kryesore të kritikës politike ndaj

qeverisjes. Diskursi opozitar u fokusua te korrupsioni i nivelit të lartë, te lidhja midis vendimmarrjes publike dhe interesave ekonomike, si dhe te pretendimi se mungesa e reagimit të shpejtë dhe të plotë ndaj disa çështjeve dëmton besimin te reforma.

Një element i përsëritur i këtij komunikimi ishte kushtëzimi politik i besimit ndaj drejtësisë. Kur veprimet e SPAK-ut perceptoheshin si goditje ndaj qeverisë, ato paraqiteshin si zhvillime pozitive; kur perceptoheshin si të pamjaftueshme ose të vonuara, diskursi zhvendosej drejt tezës së drejtësisë selektive. Kjo e bëri SPAK-un njëkohësisht institucion referimi dhe objekt kontestimi.

iii. Retorika për “ndarjen e pushteteve”

Retorika për ndarjen e pushteteve u përdor nga të dy kampet, por me funksione të ndryshme. PS/Qeveria e lidhi atë me nevojën për respektimin e institucioneve dhe mosndërrhyrjen në hetime. PD/Opozita e përdori më shumë si argument për të denoncuar presionin politik, kufizimin e kontrollit parlamentar dhe ndikimin e shumicës mbi jetën institucionale. Në të dy rastet, ndarja e pushteteve shërbeu si koncept normativ, por shpesh u përdor brenda logjikës së konfliktit politik.

Elementi	Tonaliteti i qeverisë/PS	Tonaliteti i opozitës/PD
Reforma në drejtësi	Histori suksesi dhe garanci për integrimin	E deformuar ose e pamjaftueshme në raport me korrupsionin
SPAK	Institucion flamur i reformës	Institucion i domosdoshëm, por i kontestuar për selektivitetin e perceptuar
Hetimet ndaj zyrtarëve	Provë se sistemi funksionon	Provë e korrupsionit sistemik dhe e nevojës për llogaridhënie
BE dhe drejtësia	Kusht dhe tregues për integrimin	Standard kritik ndaj qeverisjes dhe shtetit të së drejtës

Qëndrimet ndaj drejtësisë dhe SPAK-ut




Figura 1. Qëndrimet ndaj drejtësisë dhe SPAK-ut, sipas intensitetit të komunikimit publik.

Grafiku tregon asimetrimin mes dy aktorëve. PS/Qeveria ka intensitet të lartë në mbështetje dhe të ulët në kritikë, ndërsa PD/Opozita ka nivel të lartë kritikash dhe kushtëzimi politik. Kjo konfirmon se SPAK-u përdoret njëkohësisht si bosht i legjitimitetit dhe i kontestimit.

3. ROLI I FAKTORËVE NDËRKOMBËTARË

Faktori ndërkombëtar luajti rol të dukshëm në diskursin politik dhe publik të periudhës prill-qershor 2026. BE, SHBA dhe përfaqësitë diplomatike u referuan nga aktorët politikë si burime legjitimiteti, si standard kontrolli dhe si pikë orientimi për vlerësimin e reformave, korrupsionit dhe funksionimit të drejtësisë.

i. BE, SHBA, ambasadat

Në komunikimin e PS/Qeverisë, referencat ndërkombëtare u përdorën kryesisht për të mbështetur tezën e progresit institucional, të stabilitetit dhe të avancimit të procesit të integritetit evropian. Qëndrimet pozitive të partnerëve, raportet teknike dhe bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare u paraqitën si dëshmi se Shqipëria mbetet në rrugën e reformave. Në komunikimin e PD/Opozitës, faktori ndërkombëtar u përdor si arbitër kritik ndaj qeverisë. Raportet ndërkombëtare, qëndrimet e delegacioneve dhe shqetësimet mbi konkurrencën, transparencën apo korrupsionin u interpretuan si prova se standardet evropiane nuk po

përmbushen në mënyrë të plotë. Kështu, e njëjta referencë ndërkombëtare u përdor nga palët në mënyra të ndryshme: si konfirmim progresi nga njëra anë dhe si provë mosplotësimi standardesh nga ana tjetër.

ii. Qëndrimet ndaj SPAK dhe korrupsionit

Në diskursin publik, partnerët ndërkombëtarë u lidhën shpesh me mbështetjen për institucionet e drejtësisë dhe me luftën kundër korrupsionit. Kjo e rriti peshën politike të SPAK-ut në debat, pasi institucioni u vendos në qendër të pritshmërive të brendshme dhe të jashtme. Mbështetja ndërkombëtare për drejtësinë u përdor nga PS/Qeveria si provë legjitimiteti institucional, ndërsa PD/Opozita e vendosi atë në funksion të kërkesës për rezultate më të plota dhe më të barabarta ndaj korrupsionit.

iii. Ndikimi në integrim

Procesi i integritit evropian shërbeu si kornizë interpretuese për pothuajse të gjitha temat e tjera: korrupsionin, drejtësinë, Kuvendin, konkurrencën, transparencën dhe standardet e qeverisjes. Monitorimi i muajit prilli evidenton se rreth 60% e diskursit publik ishte i përqendruar te integrimi evropian dhe korrupsioni, duke treguar se këto dy tema u trajtuan si të ndërlidhura në komunikimin politik.




Figura 2. Argumentet kryesore mbi integrimin evropian dhe rolin e faktorit ndërkombëtar.

PS/Qeveria thekson progresin e negociatave dhe mbështetjen ndërkombëtare, ndërsa PD/Opozita thekson shtimin e kushteve dhe korrupsionin si pengesë. Kjo e kthen integrimin

europian nga proces teknik në instrument të garës për legjitimitet politik.

Çështja	PS/Qeveria	PD/Opozita
Negociatat me BE	Proces që ecën me ritëm të shpejtë	Proces i penguar nga korrupsioni dhe mungesa e standardeve
Raportet ndërkombëtare	Burim konfirmimi për reforma	Burim kritike ndaj qeverisjes
Kushtet e BE	Nuk paraqiten si pengesë serioze	Paraqiten si sinjal shqetësimi dhe vonese
Përgjegjësia politike	Opozita shihet si bllokuese e procesit	Qeveria shihet si përgjegjëse për pengesat

4. KLIMA POLITIKE DHE DISKURSI PUBLIK

Klima politike gjatë periudhës prill-qershor 2026 u karakterizua nga rritje e konfliktualitetit, nga mbivendosja e temave të drejtësisë me integrimin europian dhe nga përdorimi i korrupsionit si kategori qendrore e debatit publik. Diskursi politik u zhvendos nga argumentimi programor drejt betejës për legjitimitet moral dhe institucional.

i. Polarizimi politik

Të dhënat e monitorimit tregojnë se polarizimi politik u rrit gradualisht nga prilli në qershor. Në këtë pjesë krahasimi kufizohet te PS/Qeveria dhe PD/Opozita, pasi protestat qytetare trajtohen veçmas si segment i qershorit dhe jo si aktor krahasues për gjithë periudhën tremujore.




Figura 3. Evolucionit i indeksit të polarizimit politik për PS/Qeverinë dhe PD/Opozitën.

Të dy aktorët kryesorë shënojnë rritje të polarizimit nga muaji në muaj. PD/Opozita ruan nivel më të lartë polarizimi, ndërsa PS/Qeveria rrit intensitetin e komunikimit në qershor, kryesisht në përgjigje të klimës së tensionuar dhe debatit publik mbi protestën, drejtësinë dhe stabilitetin. Në plan cilësor, polarizimi nuk lidhet vetëm me ashpërsinë e gjuhës, por edhe me strukturën e debatit. Temat e integritit, korrupsionit dhe SPAK-ut u përdorën si instrumente për të ndërtuar dallime të forta morale mes palëve. Kjo e kufizoi hapësirën për gjuhë kompromisi dhe e dobësoi mundësinë e diskutimit institucional mbi politika konkrete.

Lloji i gjuhës së përdorur në diskursin publik




Figura 4. Lloji i gjuhës së përdorur nga PS/Qeveria dhe PD/Opozita.

Grafiku evidenton profile të ndryshme komunikimi. PS/Qeveria ka nivel më të lartë të gjuhës institucionale dhe ironike, ndërsa PD/Opozita dominon te gjuha denoncuese, agresive dhe mobilizuese. Të dy profilet kontribuojnë në polarizim, por përmes mekanizmave të ndryshëm komunikues.

5. DOMINIMI MEDIATIK I PS/PD

Dominimi mediatic për periudhën prill-qershor 2026 është analizuar mbi bazën e indeksit të dominimit, ndarjes së përmendjeve, volumit të përmendjeve, tonalitetit dhe burimeve kryesore të ekspozimit publik. Në këtë kapitull krahasohen vetëm dy aktorët kryesorë politikë: PS/Qeveria dhe PD/Opozita. Segmenti i protestave, për shkak se lidhet me zhvillime të qershorit, trajtohet më vete në kapitullin pasues.

i. Indeksi për dominim mediatic

Indeksi i dominimit mediatic tregon një prani më të lartë dhe më të qëndrueshme të PS/Qeverisë në hapësirën mediatike gjatë të tre muajve. PD/Opozita ka ekspozim më të ulët në indeks, por ruan prezencë të qëndrueshme në kontekst kritik dhe konfliktual. Sipas të dhënave të

monitorimit, mesatarja tremujore e indeksit ¹ është 65 për PS/Qeverinë dhe 30 për PD/Opozitën.




Figura 5. Indeksi i dominimit mediatik për PS/Qeverinë dhe PD/Opozitën.

PS/Qeveria ruan avantazh të qartë në dominimin mediatik gjatë gjithë periudhës. Rritja e qershorit për PS/Qeverinë lidhet me shtimin e komunikimit institucional dhe reagimeve ndaj klimës politike, ndërsa PD/Opozita shënon ulje të lehtë në indeks, pavarësisht intensitetit të lartë të retorikës.

¹ Për të matur është përdorur indeksi sintetik (0–100), i cili reflekton nivelin e dominimit mediatik për secilin aktor.

Ndarja e përmendjeve në media




Figura 6. Ndarja e citimeve në media, sipas muajve.

Ndarja e citimeve tregon se më shumë se dy të tretat e hapësirës mediatike të dy aktorëve kryesorë i përkasin PS/Qeverisë. Në qershor, pesha relative e PS/Qeverisë arrin 71%, ndërsa PD/Opozita 29%.

Vëllimi i përmendjeve në media




Figura 7. Vëllimi i citimeve në media, në mijë përmendje.

Vëllimi i citimeve për PS/Qeverinë rritet nga 110 mijë në prill në 130 mijë në qershor. PD/Opozita lëviz nga 50 mijë në prill në 55 mijë në maj dhe 48 mijë në qershor. Diferenca në volum ndihmon në shpjegimin e dominimit të qëndrueshëm mediatik të PS/Qeverisë.

ii. Dominimi sipas platformave

Analiza sipas platformave tregon se portalet online janë burimi kryesor i citimeve për të dy aktorët. Televizionet kanë peshë më të lartë relative për PD/Opozitën, ndërsa rrjetet sociale dhe shtypi i shkruar mbeten burime plotësuese. Kjo tregon se diskursi publik është i varur kryesisht nga cikli i shpejtë i portaleve dhe nga dinamika e televizioneve politike.




Figura 8. Tonaliteti i diskursit mediatik.

Tonaliteti i PS/Qeverisë paraqitet më i balancuar: 35% pozitiv, 40% neutral dhe 25% kritik/negativ. PD/Opozita ka ekspozim më të madh në kontekst kritik ose negativ, me 50% të diskursit në këtë kategori.

Burimet kryesore të përmendjeve




Figura 9. Burimet kryesore të citimeve mediatike.

Portalet online janë burimi kryesor për të dy aktorët: 60% për PS/Qeverinë dhe 55% për PD/Opozitën. Televizionet kanë peshë më të madhe për PD/Opozitën, me 30%, krahasuar me 25% për PS/Qeverinë. Kjo tregon se debati televiziv mbetet veçanërisht i rëndësishëm për komunikimin opozitar.

6. PROTESTAT E QERSHORIT DHE NDRYSHIMI I DISKURSIT POLITIK

Protestat e qershorit trajtohen si segment i veçantë analitik, jo si aktor krahasues për të gjithë periudhën prill-qershor. Arsyeja është se protesta si zhvillim i rëndësishëm publik mori peshë në qershor dhe ndikoi sidomos në ndryshimin e tonit, fjalorit dhe objektivave të komunikimit politik në fund të periudhës së monitoruar.

Në këtë pjesë, analiza fokusohet te reagimet ndaj protestës, te pozicionimi i qytetarëve në raport me politikën dhe te mënyra se si aktorët politikë u përpoqën ta interpretojnë protestën: si presion qytetar, si shenjë pakënaqësie, si fenomen i instrumentalizuar politikisht ose si kërcënim ndaj stabilitetit institucional.

i. Protestat dhe reagimet, qytetarët dhe politika

Diskursi ndaj protestës u karakterizua nga dy prirje të kundërta. Nga njëra anë, qytetarët dhe grupimet protestuese artikuluan kërkesa për llogaridhënie, përgjegjësi politike dhe ndryshim të modelit të përfaqësimit. Nga ana tjetër, reagimet institucionale dhe partiake synuan ta interpretojnë protestën përmes kategorive të rendit, stabilitetit, manipulimit politik ose përfaqësimit qytetar.

Në komunikimin publik të PS/Qeverisë, protesta u trajtua kryesisht përmes gjuhës së delegjitimitit, thirrjeve për rend dhe stabilitet, referencave institucionale dhe akuzave për instrumentalizim politik. Kjo nuk e përjashtoi përdorimin e gjuhës institucionale, por hapësira për gjuhë pajtuese ose dialoguese mbeti e kufizuar.

Protestat e qershorit: intensiteti i kategorive të gjuhës




Figura 10. Protestat e qershorit: intensiteti i kategorive të gjuhës së përdorur ndaj protestës.

Kategoria më intensive është delegjitimimi i protestës, me 10/10. Më pas vijnë thirrjet për rend dhe stabilitet dhe gjuha institucionale, me 9/10. Thirrjet për dialog dhe gjuha pajtuese kanë intensitet më të ulët, ç'ka tregon se reagimi dominues ishte mbrojtës dhe kontrollues, më shumë sesa ndërmjetësues.

Protestat e qershorit: ndarja e përgjithshme e tonit




Figura 11. Protestat e qershorit: ndarja e përgjithshme e tonit të gjuhës.

Sipas monitorimit, 52% e tonit të përdorur ndaj protestës ishte negativ ose delegitimues, 28% institucional/arsyetues, 12% ironik ose sarkastik dhe 8% pajtues/dialogues. Kjo e bën protestën një moment kthese në diskurs, pasi rrit polarizimin dhe redukton hapësirën për ndërmjetësim publik. Në përmbledhje, protestat e qershorit nuk duhet të lexohen si vazhdim linear i diskursit të prillit dhe majit, por si segment që ndryshoi balancën e komunikimit publik. Ato shtuan peshën e diskursit qytetar, rritën presionin mbi aktorët politikë dhe zhvendosën debatin nga përplasja klasike PS/PD drejt pyetjeve më të gjera mbi përfaqësimin, integritetin dhe përgjegjësinë publike.

Aktor/segment	Leximi analitik
Qytetarët/protestuesit	Mobilizim qytetar, kërkesë për llogaridhënie, refuzim i elitave politike.
PS/Qeveria	Theks te rendi, stabiliteti, legjitimiteti institucional dhe delegitimimi i protestës si e instrumentalizuar.
PD/Opozita	Përpjekje për ta lidhur protestën me krizën e qeverisjes dhe korrupsionin, pa e monopolizuar plotësisht narrativen.
Efekti në diskurs	Rritje e polarizimit, zhvendosje e axhendës publike dhe rritje e peshës së komunikimit emocional.